# KUJDES!

- Mos harroni të kodoni grupin (A ose B) në fletëpërgjigjen e provimit. **Fletë-përgjigjet me grupin e pakoduar nuk vlerësohen.**
- Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Nëse një pyetjeje i jepni dy përgjigje atëherë ajo pyetje do të vlerësohet si e gabuar.
- Përgjigja do të kodohet me laps. Në të kundërt kompjuteri nuk do ta lexojë.
- Përgjigjen e pyetjes do ta kodoni vetëm brenda rrethit siç është vepruar në shembullin e poshtëshënuar

  Saktë Ⓐ Ⓑ ● Ⓓ        Gabim Ⓐ Ⓑ Ⓒ Ⓓ

- Bëni kujdes për të mos dalë jasht rrethit kur të kodoni përgjigjen.
- Mos bëni asnjë veprim mbi fletë përgjigjen e provimit si zhgarravitje, rrudhosje etj.
- Mos iu përgjigjni pyetjeve për të cilat nuk jeni të sigurtë. **Kujdes! 3 përgjigje gabim fshijnë një të saktë.**
- Mos qëndroni shumë tek pyetjet që nuk zgjidhni dot, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tjera.
- Koha e provimit është **150 minuta**. Shfrytëzoni deri në fund kohën e provimit. Në qoftë se ju tepron kohë, bëjini dhe një kontroll testit.
- Përgjigjet e pyetjeve që ndodhen në këtë libërth, do të kodohen në fletë-përgjigje në pjesën ku shkruan "PERGJIGJET".
- Në provim **ndalohet** mbajtja ose përdorimi i celularit dhe makinës llogaritëse.
- Kodoni me kujdes preferencat tuaja për shkollat në të cilat dëshironi të studioni. Rezultatet dhe bursat do të shpallen sipas preferencave të bëra.

| Shkolla | Kodi |
|---|---|
| "Mehmet Akif" e Mesme - Vajza në Tiranë (me konvikt) | **01** |
| "Mehmet Akif" e Mesme - Djem në Tiranë (me konvikt) | **02** |
| "Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Tiranë (me konvikt) | **03** |
| "Hasan Riza Pasha" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Shkodër (e mesme me konvikt) | **04** |
| "Turgut Özal" 9-Vjeçare dhe e Mesme në Durrës (klasat 9-12 me konvikt) | **05** |

*Suksese!*

**1.**

$$\frac{1}{0,001}+\frac{2}{0,02}=?$$

A) 1100

B) 1200

C) 1010

D) 1020

**2.**

$$\frac{3x-6}{3}-\frac{2x+4}{2}=?$$

A) -4

B) x

C) x-2

D) 0

**3.**

Nqs. $x-2=0 \text{ } dhe \text{ } y+2=0$.

Gjej $x-y^{x-y}$.

A) 64

B) 16

C) 14

D) -14

**4.**

$$(-5)^2+(-2^2)+(-5^2)-(-2)^3=?$$

A) -4

B) 4

C) 46

D) 62

**5.**

Gjej perimetrin e figurës




A) 58x

B) 60x

C) 62x

D) 64x

**6.**

$$\frac{\sqrt{128}-\sqrt{18}}{\sqrt{50}}=?$$

A) $\sqrt{\frac{11}{5}}$

B) 1

C) $\sqrt{2}$

D) $\frac{8}{5}$

**7.**

Gjeni bashkësinë e zgjidhjeve :

$$|4-3x|=2$$

A) $\frac{2}{3}$

B) -2

C) $\left\{2;\frac{2}{3}\right\}$

D) $\left\{\frac{2}{3};-2\right\}$

**8.**

Genci, Bora dhe Mirela do të ndajnë mes tyre 550 Lekë sipas këtyre kushteve:

i) Genci do të marrë 100 Lekë më shumë se Bora.
ii) Bora do të marrë dyfishin e Lekëve të Mirelës.

Gjeni sa Lekë do të marrë Bora.

A) 90

B) 150

C) 180

D) 210

**9.**

Gjeni bashkësinë e zgjidhjeve $\frac{1}{x}\geq 0$

A) $x\leq 0$

B ) $x\geq 0$

C) $x<0$

D) $x>0$

**10.**

$$\left(1+\frac{1}{2}\right)\cdot\left(1-\frac{1}{3}\right)\cdot\left(1+\frac{1}{4}\right)\cdot\left(1-\frac{1}{5}\right)\cdots\left(1-\frac{1}{49}\right)=?$$

A) $\frac{1}{49}$

B ) 1

C) $\frac{3}{2}$

D) $\frac{72}{49}$

**11.**

Nga një stacion, niset një furgon çdo 45 minuta dhe një autobus çdo 105 minuta.Nëqoftëse nga stacioni nisen njëkohësisht një autobus dhe një furgon në orën **9:00**, në cilën orë do të nisen sërish njëkohësisht një autobus dhe një furgon?
(Gjeni kohën e parë kur kjo ndodh)

A ) 14:00

B ) 14:15

C) 14:45

D) 13:30

**12.**

|BD|=|DC| ,  |BC|=|BE| ,  $[AD]\perp[DC]$




$\angle(ACB)=60^o$ , $\angle(EAB)=40^o$ ,
$\angle(AEB)=x^o$ =?

A) 20

B ) 30

C) 35

D) 40

**13.**

ABCD është drejtkëndësh.
$|AE|=3cm, |EB|=8\ cm, |BC|=6\ cm$ .

Gjeni sipërfaqen e trekëndëshit DEC.




A ) 9

B ) 24

C) 33

D) 66

**14.**

$ABCDA'B'C'D'$ është kub. Nqs. $|AC|=4\sqrt{2}$ . Gjej vëllimin e kubit.




A) 64

B ) 48

C) 36

D) 16

**15.**

$$\frac{\frac{x}{y}}{z} : \frac{\frac{z}{y}}{x} = ?$$

A) $x^2$

B ) $\frac{1}{y^2}$

C) $\frac{z}{y}$

D) $xy$

**16.**

$$\left.\begin{array}{l} b>0 \\ \dfrac{a}{b}=-\dfrac{4}{3} \\ a+b=c \end{array}\right\} \Rightarrow ?<?<?$$

A) $a<c<b$

B ) $c<a<b$

C) $a<b<c$

D) $b<a<c$

**17.**

Nga një grup prej 46 vetash, largohen 6 burra dhe 12 gra. Numri i burrave që ngelen është sa gjashtëfishi i grave që mbetën. Sa gra kishte në fillim grupi?

A) 28

B ) 30

C) 32

D) 36

**18.**

Gjeni vlerën e x në qofte se numri katershifror 45x2 plotëpjestohet me 9.

A) 6

B) 7

C) 8

D) 9

**19.**

$2|AC|=|BC|$ , $\angle(ABC)=x^o=?$




A) $90^o$

B ) $60^o$

C) $45^o$

D) $30^o$

**20.**

$V=576\pi\, cm^3$ ,$|AB|=9\,cm$ .Gjeni rrezen e bazës së rrethit.




A) 8

B) 9

C) 10

D) 12

## U D H E Z I M

PER MENYREN E ZGJIDHJES SE PYETJEVE LOGJIKE

**Shembull :**

Cila është pllaka që mungon?






**Udhëzim:** Duke u bazuar në dy rreshtat e pare vërejmë se shigjetat tregojnë vetëm 3 drejtime (djathtas, majtas dhe poshtë). Nga lartë poshtë numri i pllakave rritet me nga një shigjetë. Pra pllaka që mungon duhet të ketë 3 shigjeta me drejtim poshtë, ndryshe nga dy pllakat e tjera. Prandaj e vetmja përgjigje e saktë është **D**.

**21.**

Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?




**22.**

Cila figurë vjen në vend të pikëpyetjes?





**23.**

Cili numër duhet të vijë në vend të pikëpyetjes?

$$\frac{2\cdot\blacksquare\ -3}{3\cdot\blacksquare\ -2} = \frac{4}{3} \Rightarrow \quad \blacksquare = ?$$

A) $-\frac{1}{3}$ B) $-\frac{1}{6}$ C) $-\frac{1}{9}$ D) 3

**24.**

Gjeni figurën, sipas rregullës së zbatuar në 2 rreshtat e parë.




**25.**

Gjeni rezultatin e veprimit të fundit.

8 □ 3 = 22

6 □ 2 = 16

7 □ 5 = 24

5 □ 4 = ?

A) 30 B) 24

C) 22 D) 18

**26.**

Cila është figura që marrim kur rrotullojmë figurën e parë $90^{o}$ nga e djathta?






**27.**

Cila figurë është e ndryshme nga të tjerat?




**28.**

Cila figurë vjen më pas?




**29.**

Cila figurë vjen më pas?




**30.**

Gjeni katrorin që mungon.



**61.** Romanin "*Djemtë e rrugës Pal*" e ka shkruar:
a. Ferenc Molnar
b. Dino Buxati
c. Elenor Porter
d. Lë Klezio

**62.** Përkufizimi: *"Është një kallëzim popullor për dukuri dhe ngjarje që mund të kenë një bazë të vërtetë.",* i përket:
a. mitit
b. fabula
c. legjendës
d. përrallës

**63.** Bëjnë pjesë në gjininë epike llojet si:
a. roman, tregim, novelë
b. roman, poezi, prozë poetike
c. tregim, novelë, poezi
d. eposi, tregim, poezi

**64.** *"Kthimi i Odiseut"* është vepër:
a. epike
b. dramatike
c. lirike
d. epiko-lirike

**65.** Figura letrare e përdorur në vargun: *"Gjallë kishte qenë, për të gjallë s'u ndie."*, është:
a. metaforë
b. anaforë
c. antitezë
d. hiperbolë

**66.** Është poezi e ndërtuar në formën e ligjëratës oratorike, ku duket sikur autori ligjëron para atdhetarëve të tij:
a. "Ëndrra e prerë"
b. "Fjalët e qiririt"
c. "Në mundsh"
d. "Lamtumirë"

**67.** Mesazhi: *"Që Shqipëria të mund të mbijetonte nga dyndjet barbare, asaj i nevojitej jo vetëm trimëria, lufta, por dhe identiteti kombëtar."*, jepet në pjesën:
a. "Kush e solli Doruntinën"
b. "Gjonomadhë e Gjatollinj"
c. "Kënga e Beratit"
d. "Vdekja e Ali Pashës"

**68.** I përket Letërsisë së Vjetër Shqipe:
a. Pjetër Bogdani
b. Naim Frashëri
c. Andon Zako Çajupi
d. Fan Noli

**69.** Kaligrama janë poezitë që i japin përparësi:
a. Anës grafike.
b. Theksojnë mesazhin e poetit përmes formës së sonetit.
c. Shkruhen gjithmonë në vargje.
d. Përdoret dendur onomatopeja.

**70.** Përkufizimi: "*Është një krahasim që realizohet në mendjen tonë.”* i përket figurës letrare të:
a. personifikimit
b. shkallëzimit
c. epitetit
d. metaforës

**71.** Përbërësit e grupit emëror luajnë rolin e:

a. Bërthamë + përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
b. Bërthamë + përcaktor kallëzuesor i kundrinorit
c. Bërthamë + përcaktor + ndajshtim
d. Kryefjalë + kallëzues

**72.** Cila nga fjalët e përbëra është shkruar gabim:
a. vetadministrim
b. shumanshëm
c. kokëulur
d. zëëmbël

**73.** Në grupin emëror: “*dinakëri dhelpre*”, përcaktori shprehet me emër në rasën:
a. dhanore
b. kallëzore
c. emërore
d. rrjedhore

**74.** Në fjalinë:"*Mbrojtja e Krujës iu ngarkua kont Uranit."*, fjala *"kont"* ka funksionin e:

a. Përcaktorit kallëzuesor
b. Emër bërthamë
c. Ndajshtim i paveçuar
d. Përcaktor me përshtatje

**75.** Dallo në cilin rast është përdorur saktë nyja e përparme:
a. Akademia e Shkencave të Shqipërisë është organizatore e panairit.
b. Ajo i besonte verbërisht fjalës së të moshuarës.
c. Genti është vëllai i shoqes sime së klasës.
d. Akademia e Shkencave e Shqipërisë rizgjodhi kryetarin e saj.

**76.** Dalloni fjalinë që ka folje kalimtare:
a. Koha ikën shpejt.
b. Atë punë qaje me lot tani.
c. Aeroplani u ul në pistë në orën e caktuar.
d. Vitet po ikin një e nga një pa kuptuar.

**77.** Tema fjalëformuese e fjalëve *"besimi, fillimin, drejtimi"*, është:

a. besim, fillim, drejtim
b. beso, fillo, drejto
c. besë, fill, drejt
d. besimi, fillimin, drejtimi

**78.** Është tipar i mbiemrave marrëdhëniorë:

a. Janë vetëm të parmë.
b. Janë vetëm të përbërë.
c. Janë vetëm të prejardhur.
d. Formojnë emra abstraktë.

**79.** Gjeni fjalinë që ka përcaktor kallëzuesor të kryefjalës:

a. Ishte punë e vështirë.
b. Mëngjesi i freskët e solli në vete.
c. Dëshira për të lexuar i lindi që në klasë të parë.
d. Mëngjesi dukej si i larë në ar.

**80.** Në fjalinë "*Në sytë <u>e nënës</u> ndriti një flakë e lehtë gëzimi.",* gjymtyra e nënvizuar është:

a. kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
b. përcaktor me përshtatje
c. përcaktor me drejtim
d. përcaktor me bashkim